1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike Shoqeria “VESA 2014” sh.p.k” & “Sali Elektrik ” sh.p.k, me vlere te ofertes 149,990,000 (njqind e dyzet e nente milion e nenteqind e nentedhjete mije) leke pa TVSH, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas DST-se se publikuar nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht ky bashkim operatoresh nuk ka permbushur kriteret:
 - ✓ Kriterin e veçantë të kualifikimit, përcaktuar në DST Kapitulli 2.3. Kapaciteti Teknik pika 1 “Përvoja te mëparshme”.
 - ✓ Kriterin e veçantë të kualifikimit, përcaktuar në DST Kapitulli 2.3.Kapaciteti Teknik pika 6 ku percaktohet: *Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe*

vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme e materialeve) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar Krieteve te DST-se te publikuar nga Autoriteti Kontraktor ku eshte percaktuar shprehimisht se: *“Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim”*; si dhe referuar nenit 53 pikes 3 te LPP-se ku percaktohet se: *Autoriteti Kontraktor, ne zbatim te pikes te ketij neni, vlereson me oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit , pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij Ligji;*

Ne keto kushte oferta e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike te mesiperm eshte refuzuar / s`kualifikuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor.

2. Operatori Ekonomik Shoqeria “G.A.C” sh.p.k me vlere te ofertes 173,701,250 (njqind e shtatedhjet e tre milion e shtateqind e nje mije e dyqind e pesedhjet e leke pa TVSH, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas DST-se se publikuar nga AK. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar , konkretisht:
 - ✓ Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik ka mangesi ne katalogjet e paraqitura per mallrat e kerkuara referuar specifikimeve teknike te publikuara nga AK. (konkretisht sensorët per matjen e temperatures, kriteri AFLR-i celave, barcodet si dhe standarti IEC per kualifikimin sizmik.)
 - ✓ Test raportet e paraqitura nuk plotesojne te gjitha kerkesat referuar Shtojces se Specifikimeve Teknike te publikuar nga Autoriteti Kontraktor.
 - ✓ Operatori Ekonomik ka mangesi ne paraqitjen e autorizimit te prodhuesit per disa nga mallrat e kerkuara (konkretisht aksesore te celave TM, sensore per matje temperature, transformatore torroidale, fisheke sigures)

Referuar Krieteve te DST-se te publikuar nga Autoriteti Kontraktor ku eshte percaktuar shprehimisht se: *“Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim”*; si dhe referuar nenit 53 pikes 3 te LPP-se ku percaktohet se: *Autoriteti Kontraktor, ne zbatim te pikes te ketij neni, vlereson me oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit , pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij Ligji;*

Ne keto kushte Oferta e Operatorit Ekonomik te mesiperm eshte refuzuar / s`kualifikuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor.

3. Operatori Ekonomik Shoqeria “DABAR” sh.p.k me vlere te ofertes 191,463,000 (njqind e nentedhjet e nje milion e katerqind e gjashtedhjet e tre mije) leke pa TVSH, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas DST-se se publikuar nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht ky operator ekonomik nuk ka permbushur kriteret si vijon:
 - ✓ Nuk plotësohet kriteri i veçantë i kualifikimit, përcaktuar në Shtojcën Specifikimet Teknike te publikuar nga Autoriteti Kontraktor ku percaktohet *“Cdo cele duhet te kete te dukshme ne*

trupin e saj ne nje barkod specifik, nepermiet te cilit te behet i mundur leximi i te gjitha te dhenave teknike me ane te skanerit, nga operatoret e oshee.

- ✓ Nuk plotësohet kriteri i veçantë i kualifikimit, përcaktuar në DST Kapitulli 2.3. Kapaciteti Teknik pika 6 ku percaktohet: *Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme e materialeve) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.*

Referuar Kriteve te DST-se te publikuar nga Autoriteti Kontraktor ku eshte percaktuar shprehimisht se: *“Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim”*; si dhe referuar nenit 53 pikes 3 te LPP-se ku percaktohet se: *Autoriteti Kontraktor, ne zbatim te pikes te ketij neni, vlereson me oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit , pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij Ligji;*

Ne keto kushte Oferta e Operatorit Ekonomik te mesiperm eshte refuzuar / s`kualifikuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor.

II. Ne lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik Shoqeria “Albesol” sh.p.k, Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur, konkludon se ky operator ekonomik ploteson Kriteret e Pergjithshmet e Pranimi / Kualifikimit. Ky operator ekonomik dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka te rregullt konform kerkesave te Dokumentave Standarte te Tenderit. Gjithashtu ky operator ploteson kriteret e vecanta te kualifikimit ne zbatim te Legjislacionit te Prokurimit Publik perkatesisht VKM Nr.914 date 29.12.2014 te ndryshuar dhe Ligjit “Per Prokurimin Publik” te ndryshuar.

Referuar nenit 53 pikes 3 te LPP-se ku percaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, ne zbatim te pikes te ketij neni, vlereson me oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij Ligji”*, Komisioni i Vleresimit te Ofertave prane AK-se ka vendosur te pranoje dhe te kualifikojë si oferte te vlefshme oferten e Operatorit Ekonomik Shoqeria “Albesol”sh.p.k.

Renditja perfundimtare e operateve ekonomike nga Autoriteti Kontraktor eshte:

Operatore ekonomike te s`kualifikuar:

- ✓ Bashkimi Operatoreve Ekonomike Shoqeria “VESA 2014” sh.p.k” & “Sali Elektrik ” sh.p.k.
- ✓ Operatori Ekonomik Shoqeria “G.A.C” sh.p.k.
- ✓ Operatori Ekonomik Shoqeria “DABAR” sh.p.k

Operator Ekonomik i kualifikuar:

- ✓ Operatori Ekonomik Shoqeria “Albesol” sh.p.k, me vlere te ofertes 184,101,010 (njqind e tetedhjetë e kater milion e njqind e nje mije e dhjetë) leke pa TVSH.

Autoriteti Kontraktor konkludoi :

Në përfundim te vleresimit, fitues i procedurës se prokurimit me objekt Blerje cela te tensionit te mesem me fond limit 197,387,750 (njqind e nentëdhjetë e shtate milion e treqind e tetedhjetë e

shtate mije e shtateqind e pesëdhjete) lekë pa TVSH, shpallet Operatori Ekonomik Shoqëria “Albesol” sh.p.k.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik Shoqëria “Albesol” sh.p.k, me adrese selie në Fushas, Njësia Administrative Baldushk, Lagjja Harazi, Rruga Fushas, godinë private me Nr.Pasurie 64/3, Magazinë nje Katëshe Nr.2 me NIPT L42307014K se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 184,101,010 (njqind e tetëdhjete e kater milion e njeqind e nje mije e dhjete) leke pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë Rajonale Tirane / OSSH sh.a, Rruga Reshit Petrela, perballe Dispanserise Tirane, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 01.04.2021.

Ankesa: Ka patur , kthyer pergjigje nga Autoriteti Kontraktor ne daten 25.03.2021

BASHKIA DURRËS

Për: NIKA Adresa :Shkoder Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”.

Procedura e prokurimit: Proçedurë “Kërkesë për Propozim” Punë.

Numri i referencës së procedurës REF-90617-03-19-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës : “Rikonstruksion rruga Vau Sals (Katund i Ri)”.
me fond limit: : 4.166.000 lekë, sasia sipas preventivit, afati 28 ditë.

Publikime të mëparshme(nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike. [Nr. 45 datë 29 Mars 2021]
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. NIKA J76705047U
Vlera 2’754’250 ((Dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë

2. RAJLI NDERTIM K71512508E
+KLAJGER KONSTRUKSION K51423028P
Vlera 2’939’500 (Dy milion e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë.

3. SARK K52531415H
Vlera 3’445’513 (Tre milion e katërqind e dyzetë e pesë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) lekë.

4. AVDULI J66703306O

Vlera 3'543'400 (Tre milion e pesëqind e dyzetë e tre mijë e katërqind) lekë.

5. ZDRAVO J84003411K
Vlera 3'551'300 (Tre milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind) lekë.

6.K - AAV L51506025C
Vlera 3'883'900 (Tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntqind) lekë.

7.SHAMO-CONSTRUCTION L01326020F
Vlera 3'930'900 (Tre milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind) lekë.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. RAJLI NDERTIM	K71512508E
+KLAJGER KONSTRUKSION	K51423028P
2. SARK	K52531415H
3 .K - AAV	L51506025C
4. SHAMO-CONSTRUCTION	L01326020F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

-Për bashkimin e ofertuesve "RAJLI NDËRTIM+KLAJGER KONSTRUKSION" me vlerë të ofertës 2'939'500 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, Në DST, Shtojca 11, pika 2.3.1 "Për kapacitetin teknik", në gërmën "g", kërkohet:

Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:

Inxhinier Ndërtim I (një)

Inxhinier Topogra I (një)

Teknik ndërtimi I (një)

Punëtori e specializuar me makineri:

- *Manovratorë* 4 *punonjës*
- *Drejtues mjete* 4 *punonjës*
- *Punëtorë ndërtimi të thjeshtë* 6 *punonjës*

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/liçenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të paraqitet një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.

Për të gjithë punonjësit e sipërpërmendur të paraqitet listëpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

Në bashkimin e operatoreve ekonomike B.O.E "RAJLI NDËRTIM+KLAJGER KONSTRUKSION";

- Inxhinier Topograf E. Manaj ka kontratë pune me "KLAJGER KONSTRUKSION" por nuk figuron në listëpagesën sipas formularëve standart për sigurimet për muajin e fundit.
- Manovratorë (4 punonjës), drejtues mjete (4 punonjës),

2 manovratorë kanë kontrata pune me operatorin “KLAJGER KONSTRUKSION” po nuk figurojnë në listëpagesën sipas formularëve standart për sigurimet për muajin e fundit. Ndërsa punojësit e paraqitur nga operatori ”RAJLI NDËRTIM” manovratorë e drejtues mjeti, kontratat e punës i kanë me operatorin “VARAKU-E” dhe jo me operatorin “RAJLI NDËRTIM” dhe nuk figurojnë në listëpagesën sipas formularëve standart për sigurimet për muajin e fundit të këtij operatori.

- Mungon vetëdeklarimi nga bashkimi i operatorëve të mësipërm për punëtorët e thjeshtë të ndërtimit.

KVO vendos që bashkimi i operatorëve ekonomike B.O.E ”RAJLI NDËRTIM+KLAJGER KONSTRUKSION” të mos kualifikohet.

-Për ofertuesin “SARK” me vlerë të ofertës 3’445’513 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit,

Në DST, Shtojca 11, pika 2.2 pika d: Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore për vitet 2018, 2019, 2020 ku duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se 4’000’000 lekë.

Ofertuesi “SARK” nuk plotëson kriterin e kërkuar pasi ka ngarkuar në sistem kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore për vitet 2017, 2018, 2019 dhe me objekt tenderimi tjetër dhe për vitin 2020 nuk ka deklarim të xhiros.

Për kapacitetin teknik, pika 2.3.1 në gërmën “h”,

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/dhëna teknike, ose ekuivalenti i tij/saj) për :

Autobot uji

(copë 1)

Operatori ekonomik “SARK” për mjetin, autobot uji, çertifikatën e kontrollit teknik e ka me datë 23.01.2021.

KVO vendos që ofertuesi “SARK” me vlerë të ofertës 3’445’513 lekë të mos kualifikohet.

-Për operatorin ekonomik “K-AAV” me vlerë të ofertës 11’942’262 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit DST;

Shtojca 11, pika 2.2, a: Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2020 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ofertuesi “K-AAV” nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2020.

Shtojca 11, pika 2.2, d: Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore për vitet 2018, 2019, 2020 ku duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se 4’000’000 lekë.

Ofertuesi “K-AAV” nuk plotëson kriterin e kërkuar pasi kopjen e deklaratave të xhiros mesatare vjetore për vitet 2018, 2019,2020 e ka në vlerë 0 lekë.

“Për kapacitetin teknik”, në gjurmën “e”, kërkohet:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 2'000'000 lekë, të realizuar gjatë tri viteve të fundit; ose Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 8'000'000 lekë; Si dëshmi për punë të ngjashme kërkohet: kontratën/kontratën me autoritetet kontraktore publike apo private të shoqëruara me faturën/faturat tatimore, formular vlerësimi sipas shtojcës e shoqëruar me akt kolaudimin dhe situacionet.

Ofertuesi “K-AAV” nuk plotëson kriterin e kërkuar pasi puna e ngjashme e paraqitur “Ndërtim kantjeri i shoqërisë K-AAV” Ura Vajgurore, Berat, me kontratë më datë 30.06.2015 nuk konsiderohet punë e ngjashme me objektin e tenderimit dhe nuk është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Në DST, Shtojca 11, pika 2.3.1 “Për kapacitetin teknik”, në gjurmën “g”, kërkohet:

Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:

<i>Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Inxhinier Topograf</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Teknik ndërtimi</i>	<i>1 (një)</i>

Punëtori e specializuar me makineri:

• <i>Manovratorë</i>	<i>4 punonjës</i>
• <i>Drejtues mjeti</i>	<i>4 punonjës</i>
• <i>Punëtorë ndërtimi të thjeshtë</i>	<i>6 punonjës</i>

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/licenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.

Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të paraqitet një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.

Për të gjithë punonjësit e sipërpërmendur të paraqitet listëpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

-Operatori ekonomik “K-AAV” ka paraqitur Inxhinier Topograf, P.Shkarpa, i cili ka kontratë pune me “K-AAV” por nuk figuron në listëpagesën sipas formularëve standart për sigurimet për muajin e fundit.

Për kriterin : Manovratorë (4 punonjës), drejtues mjeti (4 punonjës), i ka me dëshmi të skaduara dhe nuk kanë kontrata pune.

Vetëm 3 prej tyre figurojnë në listëpagesë, ndërsa të tjerët nuk figurojnë në listëpagesën sipas formularëve standart për sigurimet për muajin e fundit të këtij operatori.

Për kapacitetin teknik, pika 2.3.1 në gjurmën “h”,

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/të dhëna teknike, ose ekuivalenti i tij/saj për :

<i>Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton</i>	<i>(copë 1)</i>
<i>Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton</i>	<i>(copë 1)</i>
<i>Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar mbi 18 ton</i>	<i>(copë 1)</i>
<i>Graider</i>	<i>(copë 1)</i>
<i>Rul me vibrim</i>	<i>(copë 2)</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>(copë 1)</i>
<i>Asfaltoshtruese me krah</i>	<i>(copë 1)</i>

*Autobot Uji**(copë 1)*

Operatori ekonomik “K-AAV” ka paraqitur vetëm rul me vibrim 2 copë dhe graider me dokumentacionin e kërkuar ndërsa mungon dokumentacioni për mjetet e tjera.

KVO vendos që operatori ekonomik “K-AAV” të mos kualifikohet.

-Për operatorin ekonomik “SHAMO-CONSTRUCTION” me vlerë të ofertës 3’930’900 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit,

“Për kapacitetin teknik”, Shtojca 11, pika 2.3.1, në gërmën “g”, kërkohet:

Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:

<i>Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Inxhinier Topograf</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Teknik ndërtimi</i>	<i>1 (një)</i>

Punëtori e specializuar me makineri:

• <i>Manovratorë</i>	<i>4 punonjës</i>
• <i>Drejtues mjeti</i>	<i>4 punonjës</i>
• <i>Punëtorë ndërtimi të thjeshtë</i>	<i>6 punonjës</i>

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/licenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.

Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të paraqitet një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.

Për të gjithë punonjësit e sipërpërmendur të paraqitet listëpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

-Operatori ekonomik “SHAMO-CONSTRUCTION” nuk ka paraqitur listëpagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit.

Për kapacitetin teknik, pika 2.3.1 në gërmën “h”,

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/dhëna teknike, ose ekuivalenti i tij/saj) për :

Autobot uji (copë 1)

Operatori ekonomik “SHAMO-CONSTRUCTION” për mjetin, autobot uji, çertifikatën e kontrollit teknik e ka me datë 30.03.2021.

KVO vendos që operatori ekonomik “SHAMO-CONSTRUCTION” të mos kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: NIKA, Adresa :Shkoder Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”, se oferta e paraqitur me një vlerë të pergjithshme prej 2’754’250 lekë [dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksësme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Durrës, Sheshi “Liria” Durrës, tel/fax 052222310, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.04.2021.

Ankesa: ka ose jo __ Jo __

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A.

Për: HYDROWATER-ALBANIA &SRP Albanian Engineering shpk (bashkim operatorësh)

Adresa : HYDROWATER-ALBANIA me adrese: TIRANE Njesia Administrative nr.7, Rruga Irfan Tomini, Ndertesa nr.1, Pallati Sinani, Kati 7, Apartamenti 18

SRP ALBANIAN ENGINEERING me adrese Tirane Kashar YZBERISH Rruga “Tom Plezha”, Pallati Klensi, Shkalla 4, Kati 1, Ap.2, Yzberish

Procedura e prokurimit: *Kerkese per propozim*

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-89957-03-12-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: - Studim-Projektim i Ujesjellesit Fshatit Golem, Gjirokaster”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike :nr.42 date 23 Mars 2021
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë nje bashkim operatorësh :

1. HYDROWATER-ALBANIA me Nipt: L12414005A
SRP ALBANIAN ENGINEERING me Nipt L81728013G

Vlera e ofertuar nga ky Bashkim Operatorësh eshte : 4 097 629,47 (kater milion e nentedhjet e shtate mije e gjashtqind ne njezete e nente presje dyzete e shtate leke pa TVSH

Ky bashkim operatorësh eshte kualifikuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë HYDROWATER-ALBANIA me adrese:

TIRANE Njesia Administrative nr.7, Rruga Irfan Tomini, Ndertesa nr.1, Pallati Sinani, Kati 7, Apartamenti 18, si dhe SRP ALBANIAN ENGINEERING me adrese Tirane Kashar YZBERISH Rruga “Tom Plezha”, Pallati Klensi, Shkalla 4, Kati 1, Ap.2, Yzberish

se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 4 097 629,47 (kater milion e nentedhjet e shtate mije e gjashtëqind ne njezete e nente presje dyzete e shtate leke pa TVSH pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Ujesjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës,

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.04.2021

Ankesa: nuk ka

BASHKIA LEZHË

Për: OE A&E ENGINEERING shpk, me adrese Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Islam Alla, pallati IVEA 3/5, Tirane.

Procedura e prokurimit: Kerkese per Propozime/ Sherbime.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-90980-03-24-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: Ndertimi i ujesjellesit per zonat bregdetare te Njesise Administrative Shenkoll, Bashkia Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 48 Muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “A&E ENGINEERING” Shpk, me Nuis K72113010E, me oferte ekonomike 3,986,427.02 (tre milion e nenteqind e tetedhjetë e gjashtëmijë e katerqind e njezet e shtate pike zero dy) Lek pa Tvsh,
- 2- Operatori Ekonomik “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” Shpk, me Nuis, K71606006A, me oferte ekonomike 3,986,427.012 (tre milion e nenteqind e tetedhjetë e gjashtëmijë e katerqind e njezet e shtate pike zero dymbëdhjetë) Lek pa Tvsh,
- 3- Operatori Ekonomik “MCE” Shpk, me Nuis L72203065K. me oferte ekonomike 4,621,972,84 (kater milion e gjashtëqind e njezet e nje mije e nenteqind e shtatedhjetë e dy pike tetedhjetë e kater) Lek pa Tvsh,
- 4- Operatori Ekonomik “TOWER” Shpk, me Nuis L21717003H, me oferte ekonomike 3,986,427.02 (tre milion e nenteqind e tetedhjetë e gjashtëmijë e katerqind e njezet e shtate pike zero dy),

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik "INSTITUTI DEKLIADA - ALB" Shpk, me Nuis, K71606006A.
2. Operatori Ekonomik "MCE" Shpk, me Nuis L72203065K.
3. Operatori Ekonomik "TOWER" Shpk, me Nuis L21717003H.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I- Operatori Ekonomik "INSTITUTI DEKLIADA - ALB" Shpk, me Nuis, K71606006A

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se:

Ne piken 2.3.11, te kushteve te vecanta eshte parashikuar se: Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertës së tyre duhet ti referohen VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, Nr. 5585 Prot "Rekomandim mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", do të skualifikohen.

Sa me siper nga OE nuk eshte permbushur pika 2.3.11, pasi vlera e paraqitur ne formularin e ofertes eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar dhe ne kundërshtim te përcaktimeve ligjore te VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Qëllimi i VKM-sr nr. 354, datë 11.05.2016, është që të mbrojnë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm.

Kjo VKM e posaçme ka për qëllim të zgjidhë situatën e vështirë të krijuar në afrimin dhe përzgjedhjen e personave fizikë, apo juridikë të interesuar, të kontraktohen për shërbimet e kërkuara, pasi shpesh ka rezultuar edhe me uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar. Efekti i zbatimit të kësaj VKM është rritja e cilësisë së produktit të marrë në fushën e studimit, projektimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, nëpërmjet afrimit të profesionistëve të dalluar, duke përafuar nivelin e pagave që ato t'i përgjigjen realitetit të tregut të sotëm.

Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaçëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektuale që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive.

Në përlllogaritjen e fondit limit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar edhe vlerën minimale nën të cilën çdo operator ekonomik do të skualifikohej për ofertë të papërgjegjshme dhe jo në përputhje me përcaktimet e posaçme ligjore në fuqi dhe në rastin konkret, kur ekziston një bazë ligjore e posaçme që rregullon vlerat minimale, çdo autoritet është i detyruar ta ketë parasysh gjatë vlerësimit të ofertave dhe ta zbatojë atë me përpikmëri.

Si përfundim KVO gjykon se duke qenë se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikqyrjes duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura. Në këtë kuptim, KVO sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë të garantojnë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit” vendosi të refuzojë ofertën e OE “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. të ndryshuar, OE “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” Shpk, *skualifikohet*

II- Operatori Ekonomik “MCE” Shpk, me Nuis L72203065K.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson piken 2.3.3 në lidhje me disponimin e 15 punonjësve për periudhën shtator 2020 - shkurt 2021 pasi nga verifikimi në SPE rezulton se OE për periudhën e kërkuar ka të siguar një numër prej me pak se 10 punonjësish bazuar në listpagesat e paraqitura nga ky OE.

Se dyti, nuk ploteson piken 2.3.5 në lidhje me disponimin e stafit mbeshtetes si:

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Topograf 1 (nje)

, pasi nga verifikimi në SPE rezulton se OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon disponimin e këtij stafi mbeshtetes.

Se treti, nuk ploteson piken 2.3.7 ne lidhje me disponimin e licenses se leshuar nga QKB per "Ndikimin ne Mjedis" (kodi III.2.A) ose te kete te punësuar 1 (një) punonjes te pajisur me license, kodi III.2.A per "Ndikimin ne mjedis", pasi nga verifikimi ne SPE rezulton se OE nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe provon disponimin e kesaj license apo te kete te punësuar 1 (një) punonjes te pajisur me license, kodi III.2.A per "Ndikimin ne mjedis"

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur ne nenin 46, pika 1 germa "b" te ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit" vendosi te refuzoje oferten e OE "MCE" Shpk per mos permbushje te kriterave te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik". të ndryshuar, OE "MCE" Shpk, *skualifikohet*.

III- Operatori Ekonomik "TOWER" Shpk, me Nuis L21717003H

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson piken 2.3.4 ne lidhje me disponimin e 6 inxhinierave ne stafin e tij si drejtues teknik ne licencen e shoqerise pasi nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se ka paraqitur dokumentacion qe provon disponimin e 5 inxhinierave si drejtues teknik si me poshte:

- 1.Drejtues Teknik Inxhinier Ndërtimi, Spiro Zhebo dega - ndertime hidroteknike , rruga-ura
- 2.Drejtues Teknik Inxhinier Mekanik , Anastas Sotiri
- 3.Drejtues Teknik Inxhinier Elektrik, Gjergji Kulla
- 4.Drejtues Teknik Inxhinier Topograf/Gjeodet, Edmond Sinjari
- 5.Drejtues Teknik Inxhinier Gjeolog, Dhimiter Prifti

, por nuk ka paraqitur dokumentacion mbi disponimin e nje Drejtuesi Teknik, Inxhinier Hidroteknik.

Se dyti, nuk ploteson piken 2.3.5, ne lidhje me disponimin e stafit mbeshtetes, pasi nga verifikimi ne SPE, rezulton se mungon dokumentacion qe provon se OE disponon si staf mbeshtetes te nje Inxhinieri topograf, per te cilin nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per te provuar disponimin e ketij inxhinieri duke mospermbushur kete kriter.

Se treti, nuk permbush piken 2.3.6 ne lidhje me disponimin e 1 (nje) punonjesi te pajisur me certifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", pasi nga verifikimi ne

SPE rezulton se OE ka paraqitur dokumentacion per nje nga anetaret e stafit i cili eshte i pajisur me certifikate si “Specialist per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune”.

Theksojme se certifikimi si specialist per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune nuk permbush kerkesat e ketij kriteri pasi ne DST eshte kerkuar certifikate si Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune dhe kualifikimi si pergjegjes eshte nje kualifikim me i larte se kualifikimi si specialist.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur ne nenin 46, pika 1 germa “b” te ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit” vendosi te refuzoje oferten e OE “TOWER” Shpk, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, OE “TOWER” Shpk, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE A & E ENGINEERING shpk, me adrese Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Islam Alla, pallati IVEA 3/5, Tirane se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3,986,427.02 (tre milion e nenteqind e tetedhjetë e gjashtëmijë e katerqind e njetzet e shtate pike zero dy) Lek pa Tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Lezhe, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit dhe dokumentacionin e ofertes tuaj te noterizuar, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 08/04/2021

Ankesa: Nuk Ka

BASHKIA MAT

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “2A-P” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L21312033O, me seli: *Tiranë, Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 4, Rruga e Dibrës, Godina e Ish - Trupëroja e Shkollës Skënderbej*, dhe “K A C D E D J A” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K51712017A, me seli: *Tiranë, Tiranë, Rruga “Don Bosko”, Pallati “Meld”, Kati i dytë.*

Procedura e prokurimit: “E Hapur – Punë”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: REF-88103-02-23-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i Aneksit të Stadiumit”, me fond limit: 29 999 999.9 (*njzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntë*) lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2021 në vlerën: 2 500 000 (*dy milion e pesëqind mijë*) lekë pa TVSH, nga grandit: 1 666 666.6 (*një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë*) lekë pa TVSH, dhe nga të ardhurat: 833 333.3 (*tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tre*) lekë pa TVSH, për vitin 2022 në vlerën: 16 250 000 (*gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH, nga grandit, dhe për vitin 2023 në vlerën: 11 250 000 (*njëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH, me afat realizimi të punimeve: 4 (*katër*) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 29, datë 01 Mars 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “2A-P” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L21312033O, dhe “K A C D E D J A” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K51712017A,

Vlera: 28 230 507.8 (*njzet e tetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatë pikë tetë*) lekë pa TVSH

2. Operatorin Ekonomik: “ELDA-VL” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K67106202W
Vlera: *Nuk ka paraqitur ofertë.*

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “ELDA-VL” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K67106202W

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejt se Operatori Ekonomik Pjesëmarrës: “ELDA-VL” sh.p.k., nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike (*sipas Shtojcë 1 të DST-së*) në zbatim të nenit 17 të Vendimit

Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe dokumentat e kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit,

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “2A-P” Sh.p.k., me seli: *Tiranë, Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 4, Rruga e Dibrës, Godina e Ish - Trupëroja e Shkollës Skënderbej*, me numër Nipt-i: L21312033O, dhe “K A C D E D J A” Sh.p.k., me seli: *Tiranë, Tiranë, Rruga “Don Bosko”, Pallati “Meld”, Kati i dytë*, me numër Nipt-i: K51712017A, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: 28 230 507.8 (njëzet e tetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatë pikë tetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mat (Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike), me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 09.04.2021

Ankesa: Nuk ka patur.

BASHKIA KRUIJË

Për: [’BAMI’] sh.p.k, me adrese ne Fushe Krujë Kameras me administrator Z. Besnik Bami , me NIPT J94416206R ./

- Procedura e prokurimit: ‘ Kerkese per Propozim ‘
 - Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-91187-03-25-2021
 - Përshkrim i shkurtër i kontratës: ‘Sistemim-asfaltim i rrugës lidhëse nga rruga “Sh.Çela” – rruga “Shkollës” fshati Arrameras, Nj.A.Fushë Krujë, Krujë’
 - Fondi limit : 7’168’822 (shtatemilion e njeqind e gjashtedhjetë e tete mije e teteqind e njezet e dy mije) lekë pa t.v.sh, vënë në dispozicion nga Te ardhurat e Bashkise.
 - Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]
 - Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme
-

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ’ S.M.O.UNION ’ sh.p.k, me adrese ne Shkoder Beltoje me administrator Z. Mehdi Shaban , me NIPT J66902042Q.

- ✚ Vlera është 4'499'121,00 (katërmilion e katërqind e nentëdhjetë e nente mijë e njëqind e njëzet e një) leke pa t.v.sh
- 2. "BAMI" sh.p.k, me adresë në Fushe Krujë Kameras me administrator Z. Besnik Bami , me NIPT J94416206R.
- ✚ Vlera është : 4'367'169 (katërmilion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nente) leke pa t.v.sh .
- 3. " KEGLI DURI " sh.p.k , me adresë Durres Fushe Kruje , Lagjia Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat I ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numer pasurie 3/426 , me NIPT K94016202U , me administrator Durim Babasi
- ✚ Vlera është : 4'785'394,00 (katërmilion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e nentëdhjetë e katër) leke pa t.v.sh .
- 4. "UDHA" sh.p.k me adresë Diber Burrel Lagjia Pjeter Budi me administrator Arben Çela me Nipt K77524909Q.
- ✚ Vlera është : 4'730'644,00 (katërmilion e shtatëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) leke pa t.v.sh.
- 5. " K.TURJA " sh.p.k me adresë Durres Bubq,Budull, pranë Ures se Gjoles. me administrator Genci Turja me Nipt K81314014A
- ✚ Vlera është : 4'919'780,00 (katërmilion e nentëqind e nentëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) leke pa t.v.sh
- 6. " NIKA" sh.p.k me adresë Shkoder Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godinë 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587"me administrator Shpresa Nika , me Nipt J76705047U
- ✚ Vlera është : 5'440'814 (pesëmilion e katërqind e dyzet mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) leke pa t.v.sh
- 7. " AVDULI " sh.p.k me adresë Vlore Lagjia 10 Korriku, Rruga Perlat Rexhepi, Objekt 3-katesh nr.4, Kati 1 "me administrator Arben Avduli , me Nipt J66703306O.
- ✚ Vlera është : 6'050'492,00 (gjashtëmilion e pesëdhjetë mijë e katërqind e nentëdhjetë e dy) leke pa t.v.sh .
- 8. " SHAMO-CONSTRUCTION (HEC TRESKA) " sh.p.k me adresë Tirane Njesia Bashkiake Nr. 5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, Ap. 37, mbropa Pallateve Agimi " me administrator Enkeleida Shamo , me Nipt L22322003A .
- ✚ Vlera është : 6'087'810 (gjashtëmilion e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dhejtë) leke pa t.v.sh .

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. " NIKA" sh.p.k me adresë Shkoder Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godinë 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587"me administrator Shpresa Nika , me Nipt J76705047U.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ne pikën 2.2 të Dokumentave Standarte të Tenderit është kërkuar që operatorët ekonomik për të vertetur një aktivitet të qendrueshëm duhet të paraqesin kopje të certifikuar të vitit të fundit ushtrimor (2020) të paraqitur në autoritetet përkatëse, Administrata Tatimore dhe të konfirmuara nga ky autoritet, të cilat duhet të rezultojnë pa humbje.

Subjekti në kundërshtim me këto pike të DST-se nuk e ka paraqitur Bilancin e vitit 2020

2. “ SHAMO-CONSTRUCTION ” sh.p.k me adrese Tirane Njesia Bashkiake Nr. 5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, Ap. 37, mbrapa Pallateve Agimi ” me administrator Enkeleida Shamo , me Nipt L22322003A .

Përkatësisht për arsye të mëposhtme

Ne kundërshtim me pikën 2.3.1 të DST ku kërkohet të vërtetohet përvoja e suksesshme për realizimin e punëve të ngjashme për një objekt të vetëm jo më vlerë më të vogël se 50 % të vlerës së përlogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 3.548,411 leke, dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, subjekti ka paraqitur një kontratë nënsipermarrjeje me subjektin HEC Treska shpk, me objekt “Nërtim godinash, traseve të tubacionit, veprave të marrjes dekantuesve dhe baseneve, rruges lidhëse 6 KM si dhe rrugëve ndërmjetese të HEC Treska, 2,3 dhe 4 në fshatin Treske, Kolonjë.”, kontratë e cila është plotësisht e ezauruar për 3 viteve nga data e hapjes së tenderit konkretisht me datë 30.12.2017 dhe si e tillë nuk mund të merret në konsideratë.

Ne kundërshtim me pikën 2.3.9 të DST ku janë listuar mjetet e nevojshme dhe të domosdoshme për realizimin e kontratës, për automjetin tip Autobot Uji (cope 1) është paraqitur dokumentacioni për automjetin me targë ABR 802 (gjysëmrimorkio) në pronësi të shoqërisë GTZ Gazra teknike shqiptare i cili sic përshkruhet edhe në certifikatën e leshuar nga MPPTT nuk shërben për transportimin e ujit por të gazit të lengshëm dhe në këtë rast nuk mund të merret në konsideratë pasi nuk është një automjet që shërben për qëllimin e kërkuar. Gjithashtu për automjetin e kërkuar në DST tip Autobitumatrice, nga subjekti është paraqitur një faturë e thjeshtë tatimore për posedimin e një mjeti përkatës bitumi i cili nuk mund të merret në konsideratë pasi nuk është automjet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [’’BAMI’’ sh.p.k, me adrese në Fushe Krujë Kameras me administrator Z. Besnik Bami , me NIPT J94416206R] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [4’367’169 (katërmilion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) leke pa t.v.sh]/pikët totale të marra [SKA] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Krujë, Qender Sheshi ‘Mustafa Merlika (Kruja), pranë Zyres së Njesisë së Prokurimeve] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(brenda) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [4’499’121,00 (katërmilion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e një) leke pa t.v.sh], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 09.04.2021

Ankesa: ka ose jo: { JO }

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Krujë, nuk u paraqit asnjë ankesë sipas formularit përkatës.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Për: Operatorin Ekonomik "KASTRATI" sh.p.k., adresa: L. 14, Shkozet, Durrës.

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozim"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-90713-03-23-2021

